




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË PËR VITIN 2024




Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit



1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente në PFV në vlerë 403,279€; dhe

A2 Fatura në vlerë 112,226€ nuk ishte shpalosur në PFV-të e vitit 2024 si obligim i papaguar.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Mangësi në subvencionim të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) sipas thirrjes publike;
- B1 MINT nuk ka klasifikuar pasurinë sipas Rregullores MF-nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare; dhe
- A4 Në dy (2) raste kemi vërejtur tejkalim të afateve të parapara ligjore për pozitat si ushtrues detyre.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.


Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.



2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me probleme më të theksuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave ishin prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente dhe nënvlerësim i obligimeve në pasqyrat financiare vjetore. Në fushën e pasurive u identifikua një trajtim jo i duhur i pasurisë kapitale pas përfundimit të investimit, dhe mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë.

Ndërsa, sa i përket mospajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, ministria duhet të i forcoj edhe më tej kontrollet sa i përket: zbatimit të plotë të kriterëve të vendosura në marrëveshjet përkatëse për subvencione, dhe aplikimit të kriterëve sipas udhëzuesit për aplikim të thirrjes publike në marrëveshjet për subvencionim.

Çështjet tjera kishin të bënin me mbajtjen e pozitave si ushtrues detyre përtej afateve të përcaktuara ligjore, mos ndalja e tatimit në burim për personat jo resident dhe vonesa në themelimin e Komitetit të Auditimit.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontingjente

Gjetja	Rregullorja MF nr.01/2017, neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PFV. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Regjistri i detyrimeve kontingjente në MINT ishte mbivlerësuar për 403,279€, pasi që një (1) lëndë ishte prezantuar gabimisht dy herë duke e dyfishuar vlerën e detyrimit kontingjent. Kjo kishte ndodhur si pasojë e gabimit teknik nga departamenti ligjor me rastin e përgatitjes së listës së detyrimeve kontingjente. Për këto gabime teknike nga auditorët e jashtëm ishin sinjalizuar para korigjimit të PFV-ve.
Ndikimi	Mos raportimi i saktë i detyrimeve kontingjente ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente në PFV-të vitit 2024.
Rekomandimi A1	Ministrja, duhet të siguroj kontrole efektive dhe një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontingjente të mbahen pa gabime në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Nënvlërim i obligimeve në PFV****Gjetja**

Sipas nenit 17.3 të Rregullores MF nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor, "Organizatat Buxhetore duhet t'i raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) për vitin raportues".

Fatura për projektin "Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial në Budrigë" në vlerë 112,226€, e pranuar në muajin qershor 2023, dhe e papaguar në vitin 2024 nuk është raportuar si obligim në Pasqyrat Financiare Vjetore. Pranimi teknik i punimeve të këtij projekti është bërë nga komisioni i pranimit në muajin nëntor 2023, i cili ndër të tjera ka konstatuar vlerën e obligimit sipas faturës së pranuar.

Fatura nuk është procesuar për pagesë nga personat përgjegjës të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (pa u konsultuar me departamentin e financave), me arsyetimin se operatorit ekonomik (OE) duhet t'i kërkohet lëshimi i një fature të re me datë pas pranimit teknik. OE nuk ka lëshuar faturë të re për shkak se fatura ekzistuese është deklaruar tashmë në Administratën Tatimore përmes librave të shitjes, dhe çdo ndryshim do të cenonte përputhshmërinë tatimore.

Arsyeja e mos raportimit të obligimit në PFV ishte mos komunikimi i duhur në mes drejtorive përkatëse dhe hezitimi nga personat përgjegjës për pagesë të faturës.

Ndikimi

Mos prezantimi i faturës së papaguar në kohën e duhur ka ndikuar në nënvlerësimin e obligimeve dhe rrjedhimisht edhe në prezantimin jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një kordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të papaguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Mos respektimi i kriterëve për subvencionimin e NVM-ve

Gjetja

Kriteret për dhënien e subvencioneve për përkrahje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) janë të definuara me anë të thirrjes publike, marrëveshjeve midis MINT/KIESA dhe subjektit përfitues apo edhe përmes udhëzuesit për thirrje publike për subvencionimin e NVM-ve.

Ne identifikuam mangësitë si në vijim:

- Marrëveshja e nënshkruar për subvencionimin e blerjes së makinerisë e datës 24.09.2024 midis MINT/KIESA dhe subjektit përfitues ka përcaktuar afatet dhe kushtet për blerjen e makinerisë dhe vendosjen e saj në funksion, duke specifikuar se ky proces duhet të realizohet brenda një periudhe 6 mujore pas nënshkrimit të marrëveshjes. Në një rast përfituesi i subvencionit në vlerë 35,000€ për blerjen e makinerive prodhuese/përpunuese përfituesi kishte realizuar transaksionet bankare për blerjen e makinerisë para nënshkrimit të marrëveshjes (Transaksionet janë kryer në periudhën maj-korrik 2024, kurse marrëveshja ishte nënshkruar në shtator 2024); dhe
- Në shtatë (7) raste në vlerë prej 54,500€, MINT/KIESA kishte nënshkruar marrëveshjet me përfituesit duke autorizuar pagesën e përfituesve në masën 100% që në fazën e parë. Ky veprim është në kundërshtim me udhëzuesin e thirrjes publike për subvencionimin e NVM-ve, i shpallur nga MINT/KIESA në pikën 6 - "Sqarime Shtesë", paragrafi 5 përcakton që: Pas nënshkrimit të marrëveshjeve, ndërmarrjeve përfituese do t'u transferohen 80% e vlerës së aprovuar të subvencionit, ndërsa pjesa e mbetur, 20%, do të transferohet pas realizimit të plotë të projektit." Para nënshkrimit të marrëveshjes, përfituesit kanë dorëzuar garancinë bankare në vlerën 100% të grantit, në mënyrë që, në rast të dështimit të projektit, mjetet të kthehen në MINT.

Këto mangësi sipas zyrtarëve përgjegjës kanë ndodhur si pasojë e volumit të madh të punëve dhe konfuzionit me një thirrje tjetër të mëhershme të shpallur nga MINT/KIESA, ku udhëzuesi parashihte pagesën 100% të mjeteve ndaj furnizuesve. Gjatë kohës së auditimit, maj 2025, komisioni monitorues në lidhje me transaksionet e kryera para marrëveshjes ka inicuar dhe përgatitur një raport për menaxhmentin duke konstatuar mangësitë e lartëcekura dhe KIESA ka kërkuar nga përfituesi kthimin e mjeteve.

Ndikimi

Kontrollet jo efektive nga ana e komisionit monitorues dhe mos ndarja e pagesës siç parashikohet me udhëzues ka ndikim në transparencën e procesit dhe rritë rrezikun që procesi i raportimit nga ana e përfituesve të ngjizohet duke ulur kështu edhe besueshmërinë e procesit të monitorimit.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të siguroj monitorim efektiv për të parandaluar të gjitha anashkalimet e kriterëve të përcaktuara me marrëveshjet e nënshkruara apo udhëzuesit e secilës thirrje përkatëse për subvencionim. Po ashtu, në rastet e shkeljeve të konstatuara duhet të merren të gjitha veprimet e

parapara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mbajtja e pasurisë jo financiare kapitale si investim në vijim

Gjetja Rregullorja MF-nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në nenin 11 përcakton se pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim dhe nga momenti i aftësimit për përdorim, do të zbatohet zhvlerësimi.

Ne identifikuar se projekti "Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial Budrigë", në vlerë 1,709,282 ishte përfunduar në vitin 2023. Komisioni i themeluar nga MINT pranimin teknik e kishte bërë në nëntor 2023, mirëpo pasuria ende figuron e regjistruar si investim në vijim në regjistrat e pasurisë në SIMFK. Edhe pse pasuria ishte e gatshme për përdorim për shkak që situacioni i fundit prej 112,226€ nuk ishte paguar ajo po mbahej në regjistra si investim në vijim duke mos aplikuar zhvlerësimin.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet njësive përkatëse dhe mospërditësimit të duhur të regjistrave kontabël në momentin e përfundimit të investimit.

Ndikimi Mosklasifikimi i pasurisë kapitale si pasuri në përdorim ka ndikuar që zhvlerësimi të mos aplikohet dhe si pasojë kemi mbivlerësim të pasurive dhe rrjedhimisht edhe pasqyrim jo të saktë të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B1 Ministria duhet të sigurojë që për projektet të cilat janë të përfunduara dhe janë bërë pranimet teknike, të bëhen rregullimet e nevojshme në regjistrat e pasurisë ashtu që vlera e tyre në regjistra të pasqyrohet sipas rregullores.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

Gjetja Ligji për Zyrtar Publik Nr.08/L-197 në nenin 35 pikën 3 thekson se zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.


Në dy raste identifikuar se kishte tejkalim të afatit ligjor për mbajtjen e pozitës si ushtrues detyre. Pozitat mbaheshin me ushtrues detyre që nga hyrja në fuqi e ligjit (shtator 2023), e deri në kohën e auditimit (maj 2025).

Kjo situatë ishte shkatuar nga fakti që për rastin e parë nuk kishte ndonjë proces rekrutues, ndërsa për rastin e dytë ishte hapur dy herë konkursi mirëpo procesi i rekrutimit kishte dështuar.

Ndikimi Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga zyrtar që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për pozitat adekuate.

Rekomandimi A4 Ministrja duhet të siguroj se po ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me ushtrues detyre me pozita të rregullta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



infosoft.com

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2024 ishte 7,559,267€, prej tyre ishin shpenzuar 1,651,971€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shpenzime të udhëtimit, dreka zyrtare etj.

Çështja A5 - Mos ndalja në burim e tatimit për shërbimet e ofruara nga personat jorezidentë

Gjetja

Sipas nenit 41, pikës 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, të gjitha pagesat bruto për shërbime të kryera nga persona jorezidentë në territorin e Republikës së Kosovës i nënshtrohen tatimit në burim me normën 5%.

Ne kemi vërejtur se MINT kishte një kontratë me një ekspert të jashtëm jo rezident në vlerë 74,900€. Nga pagesa e parë për ekspertin jo rezident në shumën prej 63,444€ për shërbimet e ofruara kemi vërejtur se Ministria nuk kishte aplikuar ndalesën në burim të tatimit.

Moszbatimi i mbajtjes në burim të tatimit ka ndodhur për shkak të mungesës së njohurive nga ana e zyrtarëve financiarë dhe administrativë të ministrisë lidhur me obligimin për ndaljen në burim të tatimit për pagesat ndaj personave jorezident.

Ndikimi

Mosaplikimi i ndaljes së tatimit në burim ndikon në uljen e të hyrave të buxhetit të shtetit dhe e ekspozon Ministrinë ndaj detyrimeve tatimore shtesë, përfshirë kamata dhe gjoba nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Rekomandimi A5

Ministrja duhet të sigurojë që për çdo pagesë ndaj personave jorezidentë të aplikohet mbajtja e tatimit në burim prej 5% siç e parasheh ligji. Po ashtu, duhet të merren veprime konkrete që në pagesën e mbetur për kontratën e lartëcekur të aplikohet tatimi në burim për tërësinë e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 14,162,530€, pasurive jokapitale është 126,793€, si dhe e stoqeve 4,467€.

Çështja B2 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

Gjetja

Neni 19.4 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare, përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili është përgjegjës për: Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që janë në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore, verifikimi fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, dhe hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare.

Komisioni i inventarizimit kishte bërë inventarizimn e pasurisë për vitin 2024, ku kishte përpiluar Raportin gjithëpërfshirës të pasurisë jo financiare, mirëpo më tej nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive nga komisionet e inventarizimit të pasurive dhe mos kordinimit në mes të departamenteve përkatëse të MINT për evidentimin final të pasurisë së Ministrisë.

Ndikimi

Mungesa e inventarizimit të pasurive pamundëson krahasimin e rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive, prandaj vlera e pasurive në PFV mund të mos jetë e saktë.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka njohuritë dhe informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkcioni i auditimit të brendshëm

Çështja C1 - Vonesë në themelimin e Komitetit të Auditimit

Gjetja

Neni 8 dhe 10 i Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik përcakton se Komiteti i Auditimit mban takime së paku katër herë në vit, poashtu edhe përgatit raportin vjetor i cili dorëzohet udhëheqësit të subjektit të sektorit publik më së largu deri më 31 mars.

Komiteti i Auditimit nuk ishte themeluar deri në nëntor 2024 dhe pas themelimit nuk kishte mbajtur asnjë takim në vitin 2024. Po ashtu, nuk ishte përgatitur raporti vjetor i Komitetit të Auditimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve të ndërmarra nga ministria për themelimin e Komitetit të Auditimit, por edhe jo efikasitetit të tij pas themelimit.


Ndikimi

Mungesa e takimeve të Komitetit të Auditimit ndikon në mbikëqyrjen e punës së auditimit të brendshëm dhe nivelin e efektivitetit të kontrolleve.

Rekomandimi C1

Ministrja duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit të mbaj takime të rregullta në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja efektive ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	24,779,271	23,660,947	12,132,996	33,912,794	26,818,339
Grante Qeveritare - Buxheti	24,779,271	23,641,946	12,130,719	27,434,081	24,000,365
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	6,478,712	2,817,974
Donacionet e jashtme	0	19,001	2,277	0	0

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 1,118,324€. Kjo zbritje është rezultat i zvogëlimit të buxhetit përmes vendimeve qeveritare.


Në vitin 2024 MINT ka shpenzuar 51% të buxhetit final ose 12,132,996€, me një rënie prej 30% në krahasim me vitin 2023. Zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	24,779,271	23,660,947	12,132,996	33,912,794	26,215,968
Pagat dhe mëditjet	2,509,448	2,260,670	2,258,481	2,120,076	1,779,595
Mallrat dhe shërbimet	7,745,543	7,559,267	1,651,971	10,414,455	11,586,857
Komunalitë	158,280	98,280	75,969	98,041	42,437
Subvencionet dhe transferet	5,246,000	7,321,730	6,497,071	18,754,543	12,222,613
Investimet Kapitale	9,120,000	6,421,000	1,649,504	2,525,678	584,466

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasur me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 248,778€ përmes vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte afër 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 186,276€. Zvogëlimi është bërë përmes vendimit të Qeverisë si kursime buxhetore pasi MINT ka deklaruar fonde të lira 205,277€ ndërsa nga donacionet kishte rritje të buxhetit 19,001€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte afër 22%. Niveli i ulët i realizimit ishte nga mos shpenzimi i mjeteve për rezerva shtetërore;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 60,000€ përmes vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 77%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,075,730€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverisë, për zbatimin e mases 2.1 për subvencionimin e kredisë investive në vlerë 76,730€ dhe vlera prej 1,990,000€ ishte transferuar nga kategoria e investimeve kapitale. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte afër 89%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,699,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverisë për kursime buxhetore në vlerë 700,000€ si dhe vlera prej 1,990,000€ ishte transferuar në kategorinë subvencione dhe transfere. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte vetëm 1,649,504€ apo afër 26%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MINT në 2024 ishin në vlerë prej 2,059,878€. Ato kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importimin e duhanit, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	2,845,380	2,845,380	2,059,878	2,105,854	2,609,786
Të hyrat jo tatimore	2,845,380	2,845,380	2,059,878	2,105,854	2,469,937
Të hyrat tjera	0	0			139,849

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të MINT ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime. MINT ka përgatitur Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte në proces, dhe dy (2) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj koordinim në mes të zyrtarëve përgjegjës dhe se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrat të pasurive për të siguruar se ato janë kategorizuar drejtë, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta dhe raportim të drejtë në PFV. Po ashtu, të sigurojë që për projektet për të cilat janë bërë pranimet teknike, të bëhen rregullimet e nevojshme në regjistrat e pasurisë ashtu që vlera e tyre në regjistra të pasqyroj gjendjen e saktë.	Edhe këtë vit kishte raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga zyrtarët përgjegjës në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Gjatë vitit 2024 nuk kemi hasur në raste të keqklasifikimit.	I zbatuar
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.	Është realizuar monitorim i vazhdueshëm i zyrtarëve, ku për një pjesë është vërtetuar vijueshmëria dhe përmbushja e detyrave përmes raporteve dhe nënshkrimeve, ndërsa ndaj 12 zyrtarëve me mungesa të pajustificuara janë ndërmarrë masa disiplinore deri në largim nga puna.	I zbatuar
4.	Çështjet e përbashkëta	Ministrja duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet menaxherit të prokurimit me njësitë kërkuuese për të diskutuar kërkesat e tyre me kohë për prokurim, në mënyrë që të ketë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla për vitin 2024.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka njohuritë dhe informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2023.	Edhe këtë vit nuk është kryer harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Auditimi i Brendshëm	Ministrja duhet të sigurojë që në një afat sa më të shkurtër kohor të funksionalizoj Komitetin e Auditimit në MINT në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja efektive ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.	Gjatë muajit nëntor është themeluar komiteti i auditimit, por nuk kishte mbajtur takime për vitin 2024.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Arnisa Aliu, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

 MINISTRITIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE				 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVO MINISTRIJA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE			
Nr. Dokumenti: 78 Nr. Dokumenti: 78 Nr. Dokumenti: 78				Nr. Dokumenti: 78 Nr. Dokumenti: 78 Nr. Dokumenti: 78			
Data: 26.06.2025 Data: 26.06.2025 Data: 26.06.2025				Data: 26.06.2025 Data: 26.06.2025 Data: 26.06.2025			

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
 Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrimesh, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyres Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për vitin 2024,
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit,
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Zgj. Rozeta Hajdari
 Ministre në detyrë e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Data: 26 Qershor 2025

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.